



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian

Telecommunications Union SHPK

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën Nr. 676 Prot., datë 27.11.2018 “Njoftim për kryerje transaksioni dhe kërkesë për interpretim”, shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK, ka njoftuar në lidhje me transaksionin mbi blerjen e kuotës së shumicës prej 85% të aksioneve të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Referuar “Marrëveshje për shitblerjen e kuotës” palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Albanian Telecommunications Union SHPK, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar me datë 25.02.2010 me objekt aktiviteti; zhvillimin dhe funksionimin e telekomunikacioneve/elektronikës në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në zhvillimin e komunikimeve elektronike nëpërmjet transmetimit të sinjaleve përmes komunikimeve elektronike, që përfshin shërbime të telekomunikacioni, televizionit kabllor dhe shërbime të tjera të lidhura me të, zhvillim i linjës tokësore Wireless, etj.

Pala shitëse: INFO-Telecom SHPK, është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më datë 02.12.2009, me objekt veprimtarie në fushën e komunikimeve elektronike, transmetimit të dhënave dhe internetit, rrjetit dhe shërbimeve për telefoni, shërbime të linjave me qera, shërbime Voip, IP TV etj.

Shoqëria INFO-Telecom SHPK është një nga ortakët e shoqërisë Digicom SHPK.

Target: Digicom SHPK është një shoqëri e regjistruar në sipas legjislacionit shqiptar më datë 18.08.2014, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti: shërbime në fushën e komunikimeve elektronike si: Operator i rrjetit dhe shërbimeve për transmetim të dhënash/internet.Operator i rrjetit dhe shërbimeve për telefoni publike të qëndrueshme (telefoni fikse). Shërbime të transmetimit të të dhënave. Shërbime të linjave me

qera. Shërbim telefonie me kartë të parapaguar. Shërbim Voip. Shërbime të trasnmetimit të të dhënave (data) IP TV, etj.

Pala shitëse shoqëria INFO-Telecom SHPK dhe pala blerëse shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK më datën 29 tetor 2018 kanë nënshkruar “Marrëveshje për shitblerjen e kuotës”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.